

V E N D I M
Nr.334, datë 25.7.1994

PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.47, DATË 7.2.1994
“PËR KRITERET E VLERËSIMIT TË PRONËS SHTETËRORE QË PRIVATIZOHET OSE
VENDOSJET NË SHOQËRITË E PËRBASHKËTA, SI DHE PËRCAKTIMIN E QIRASË PËR
OBJEKTE SHTETËRORE QË U JEPEN NË PËRDORIM TË TRETËVE”

Me propozimin e Ministrisë së Burimeve Minerare dhe Energjetike, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.47, datë 7.2.1994, pas pikës 1/1 të kreut të parë “Për vlerësimin e elementëve të pasurisë dhe kompetencat” shtohet pika 1/2 me këtë përmbajtje:

“Për vlerësimin e kabinave elektrike me muraturë, në vlerën e mbetur nuk merret parasysh vendndodhja e objektit për efekt të shtesave ose pakësimeve”.

2. Në kreun e parë, në pikën 2 “Për makineritë dhe pajisjet” shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Për disa elementë të rrjetit elektrik, si kablllo, linja ajrore të tensionit të ulët e të mesëm dhe transformatorët e fuqisë, në llogaritjen e VAMI-it vlefte e merremtimeve të mëdha shumëzohet me koeficientin 0.2. Vlera e mbetur aktuale pas llogaritjeve të mos rezultojë më e madhe se vlera fillestare”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi